

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	02.07.2024	Ne vitin 2022 ju krijuat platformën e Transportit, e cila në vetvete përfshinte aksesin e qytetarëve në bileta elektronike, duke përfshirë këtu linjat brenda qytetit të Tiranës apo edhe jashtë këtij qarku. Pavarësisht kësaj, kanë kaluar dy vite dhe nëse kërkon të blesh një biletë elektronike në sistemin e DPSHTRR-së, sistemi të bën me dije se ky veprim nuk është i mundur, për shkak të problemeve me fiskalizimin. Psejet vijojmë si më poshtë: 1) Cilat janë arsyet për të cilat sistemi elektronik i biletave nuk është vendosur në punë? 2) Kur pritet që ky shërbim të bëhet i mundur për qytetarët? 3) Sa para janë vendosur në dispozicion për implementimin e kësaj platforme?	08.07.2024	Ne përgjigje të email-it tuaj, protokolluar në DPSHTRR, lidhur mbi kërkesën për informacion mbi biletimin elektronik, ju informojmë si më poshtë: Ne kërkesën e dërguar nga ana juaj, rezultoi se kërkonte informacion për aksesin e qytetarëve për biletat elektronike, për linjat brenda qytetit të Tiranës dhe jashtë këtij qarku. Sqarojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka kompetencën vetëm për veprimtarinë e transportit ndërqytetës të subjekteve. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 224, datë 13.04.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 85, datë 8.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor", u ndërmorën disa hapa në drejtim të përmirësimit të shërbimit në transportin ndërqytetës, ku u vendos se bileti në transportin ndërqytetës do të kryhej nëpërmjet platformës elektronike e Transportit. Për pyetjet e shtruara nga ana juaj, ju informojmë si më poshtë: 1. Cilat janë arsyet për të cilat sistemi elektronik i biletave nuk është vendosur në punë? Platforma elektronike e Transportit është fokusuar në disa shtylla kryesore që janë: menaxhimi, shërbimet, monitorimi, biletimi, implementimi i të cilave kalon në 2 faza. Faza e parë parashikonte krijimin e moduleve për ofrimin e shërbimit nga DPSHTRR-ja në sektorin e transportit ndërqytetës si dhe krijimin e moduleve për gjenerimin e biletës nëpërmjet platformës. Faza e parë e platformës elektronike e Transportit, është tërësisht funksionale, ku ofrohet shërbimi për subjektet e transportit ndërqytetës dhe janë krijuar modulet e biletimit në platformë. Implementimi i biletimit elektronik nëpërmjet platformës, kërkon dhe instalimin e pajisjeve të transaksionit elektronik të biletimit në mjete si dhe zhvillimin e moduleve të tjera që do të ndërveprojnë me këtë platformë për realizimin e blerjes online të biletës, indeksimin e tarifave të udhëtimit nga Këshilli i Ministrave, pika këto të cilat lidhen me fazën e 2-të të implementimit të projektit. Në lidhje me fazën e 2-të që nevojitet për realizimin e procesit të biletës elektronike, Ministri i Infrastrukturas dhe Energjisë, me Udhëzimin nr. 21, datë 26.10.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 3743, datë 10.7.2017, "Mbi modulet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve", të ndryshuar, ka parashikuar se pajisjet e transaksionit elektronik të biletimit, të cilat instalohen në mjete dhe nevojiten për gjenerimin e biletës nëpërmjet platformës, do të jepen në përdorim nga DPSHTRR-ja. Menjëherë pas daljes së Udhëzimit, nga ana e DPSHTRR-së ka filluar puna për realizimin e fazës së dytë të këtij projekti, por procedurat e tenderimit për blerjen e pajisjeve zhvillohen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), ku jemi në pritje nga AKSHI për finalizimin e këtij procesi. 2. Kur pritet që ky shërbim të bëhet i mundur për qytetarët? Projekt do të jetë gati sapo të përfundojë procesin e instalimit dhe konfigurimit të pajisjeve në mjete të transportit rrugor, proces i cili udhëhiqet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. Platforma për realizimin e biletës elektronike të biletimit sipas tarifave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 92, datë 21.02.2024, është funksionale. Përfundimi i fazës së dytë, që përfshin instalimin e pajisjeve në mjete të transportit rrugor, do të jetë dhe nisja e procesit të biletimit elektronik. 3. Sa para janë vendosur në dispozicion për implementimin e kësaj platforme? Në fazën e parë të projektit e Transportit është mundësuar krijimi i një platforme komplekse ku janë integruar të gjithë aktorët e sektorit të transportit publik interurbani. Nëpërmjet kësaj platforme, është mundësuar digitalizimi i të gjitha procedurave që kanë të bëjnë me licencimin, oraret, certifikimin, stacionet me qëllim eliminimin e kontakteve, shkurtrimin e kohës së procedurave dhe rritjen e transparencës. Kjo platformë i ofron në të njëjtën kohë subjekteve të transportit, pa pagesë, mundësi menaxhuese të burimeve njerëzore dhe financiare, duke formalizuar sektorin dhe rritur transparencën. Platforma e Transportit nëpërmjet webfaqes www.transport.al i ofron publikut informacion në lidhje me destinacionet, itineraret, oraret e nisjeve dhe kohëzgjatjen e udhëtimit për çdo linjë që operon në transportin ndërqytetës. Investimi total deri tani është 188,652,000 lekë pa TVSH, ku parashikohet implementimi dhe 4 vite mirëmbajtje. Duke marrë në konsideratë interesimin tuaj, do ju informojmë në vazhdim sapo të kemi zhvillime të reja mbi këtë projekt. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,	E plotë	0
2	26.08.2024	Pershëndetje e nderuar, Me dt 09.05.2024 kam bërë kërkesë pranë KSHIA Laq për konvertimin e patentës polake në patentë shqiptare. Prej kësaj date nuk kam marrë asnjë informacion dhe asnjë përgjigje. Pres nga ana juaj t' më udhëzoni pasi nuk po kuptoj zgjedhjen kohore.	06.09.2024	Në vijim të email-it tuaj, të protokolluar në DPSHTRR me, në lidhje me kërkesën për informacion për konvertimin e Lejeve Drejtimit Polake, ju informojmë se: Republika e Shqipërisë nuk ka marrëveshje dypalëshe për njohjen e ndërsjelltë dhe konvertimin e Lejeve të Drejtimit Polake. Si rrjedhim, DPSHTRR i është drejtuar me kërkesë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për verifikimin e vërtetësisë së Lejeve Drejtimit Polake në emërin tuaj. Kjo e fundit, komunikon nëpërmjet kanaleve diplomatike me autoritetet polake dhe informon me tej DPSHTRR-in, në momentin e kthimit të përgjigjes pozitive nga autoriteti i huaj. Lidhur me Leje Drejtimit Polake, nuk kemi marrë akoma një përgjigje. Në momentin e mbërritjes së përgjigjes pozitive, DPSHTRR do të njoftojë të interesuarin për vazhdimin e procedurës së konvertimit të Lejeve Drejtimit Polake në Leje Drejtimi Shqiptare.	E plotë	0
3	26.08.2024	Miredita, Ju lutem gjemi me poshte nje anekse drejtuar institucionit tuaj. Ankesen e kam dorezuar fillimisht tek Avokati i Popullit (cc per dajen) i cili sot me rekomandoi qe ta dorezoj fillimisht prane DRSHTRR. Ju lutem konfirmoni marrjen e ketij emaili dhe me pas veprimi sipas ankeses.	03.09.2024	Në përgjigje të ankesës suaj me e-mail datë 12.08.2024, protokolluar me tonën nr. 16341, datë 26.08.2024, lidhur me pagesën e kryer mbi tarifën e rinovimit të lejes së drejtimit e cila kushton 4,500 lekë, ju sqarojmë si më poshtë: Në zbatim të gërmasë të nenit 2 dhe nenit 3 të Ligjit 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe shkresës nr. 6/1 prot., datë 16.01.2024 "Mbi miratimin e vendimit nr. 4, datë 22.12.2023 të Këshillit Drejtues", nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë, tatimi mbi vlerën e shtuar i nënshtrohet të gjitha furnizimit e mallrave dhe shërbimeve, të kryera kundrejt pagesës, si dhe personi i tatueshëm konsiderohet çdo person, i cili kryen një veprim ekonomik. Për sa më sipër, tarifa për shërbimin "Pajisje me lejedrejtimi" dhe tarifa për shërbimin "Rinovim lejedrejtimi" me afat vlefshëm 15 vjeçar është e përllogaritur sipas analizës së kostos së shërbimit me vlerën 4,500 lekë me TVSH.	E plotë	0
4	30.08.2024	Pershendetje. Jam nje qytetar nga Fieri dhe para disa ditesh kam bere targinin e nje makine qe kam blere ne Koren e Jugut.(Audi A4, 2.0 TDI viti prodhimit 2015). Problemi im eshte fakti qe kategoria mjedisore e mjetit me eshte shemuar Euro 5 kur makina eshte Euro 6 pasi disponon sistem Adblue (Sic mund ta shifni ne foton bashkangjitur te lejes se qarkullimit) gjithashtu edhe viti i prodhimit te makines eshte vendos 2014 kur makina eshte blere per vitin 2015 gjegjesisht eshte e pasqyruar ne dokumenta e paraqitura ne momentin kur eshte bere rregjistrimi i mjetit. Jam paraqitur pran drejtoris perkatese ne Fier por nuk kam marre zgjidhje te problemit per sa i perket kategorise mjedisore. Kerkesa ime eshte se si duhet te veproju per te bere ndryshimin e kategoris mjedisore pasi me penalizon per te udhetuar jasht me makine. Faleminderit.	03.09.2024	Pershendetje. Në përgjigje të kërkesës suaj protokolluar në DPSHTRR, për ndryshimin e kategorisë mjedisore për mjetin me nr identifikimi. Ju bëjmë me dije se: Gjatë verifikimit të mjetit pranë platformës Partlink24 rezultoi se mjeti me nr identifikimi është me normë mjedisore Emission standard EU6 plus. Gjithashtu mjeti rezultoi i prodhuar me datë 15.10.2014 dhe regjistruar për herë të parë më 17.12.2014. Bashkëngjitur kemi të dhënat teknike në formatin pdf të mjetit nga platforma Partlink24 dhe printsc regjistrimin për herë të parë njëzëri nga faqja zyrtare e Republikës të Koresë së Jugut për ç'rregjistrimin për export. Sa më sipër paraqituri pranë Drejtorisë Rajonale sipas vendbanimit për të ndjekur procedurat. Ju faleminderit,	E plotë	0